

V E N D I M
Nr.463, datë 3.10.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.345, DATË
10.8.1992 “PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 paga bazë minimale mujore për punonjësit bëhet 2620 lekë në muaj.

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Paga mesatare mujore për vitin 1994, për efekt kontrolli, sipas ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore për ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore e pjesërisht jobuxhetore të sistemit të tyre, është sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore kanë të drejtë ta rritin deri në 50 për qind pagën mesatare të miratuar për ndërmarrjet e institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore të sistemit të tyre, që punojnë me material të porositësit ose ku zbatohet sistemi i punës me akord”.

3. Në pikën 10 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e tretë fjalët “... mbi 5 deri në 50 për qind...” zëvendësohen me fjalët “... mbi 5 deri në 70 për qind...”

- Në paragrafin e katërt fjalët “... mbi 50 për qind...” zëvendësohen me fjalët “... mbi 70 për qind...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 tetor 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi